

STUDIMET NË UNIVERSITETET E NORVEGJISË

I. KUSHTET THEMELORE DHE TË PËRGJITHSHME PËR PRANIM

I.1. Kushtet e përgjithshme

- ✚ **Së pari duhet pasur një certifikatë** valide e cila i plotëson kushtet për t'u pranuar në institutet e arsimit të lartë në vendlindje
- ✚ **Duhet të dokumentohen njohuri të gjuhës angleze.** Mjafton nëse është mësuar gjuha angleze si gjuhë e parë internacionale së paku 7 vite në shkollën fillore dhe të mesme.

Nëse gjuha angleze nuk është mësuar në shkollë si përshkruar më sipër, duhet marrë një test të gjuhës. Testet e aprovuara janë IELTS- test dhe TOEFL. Zakonisht të dy testet ofrohen nga ambasada në vend, kurse në rastin e Kosovës – nga UNMIK-u.

Testi TOEFL mund të merret edhe në internet. Për më shumë informata lidhur me këtë mund të merret në faqën e internetit www.toefl.com ku në hyrjen e faqës gjenden detyra përgatitore për test, dhe informacion se si mund të merret testi përmes internetit. Pyetje mund të drejtohen edhe në zyrën e tyre në Hollandë:

Adresa: Cito-TOEFL

P.O. Box 1203 6801 BE Arnhem The Netherlands E-mail: registration@cito.nl Numri i telefonit: + 31 26 352 1480

Faksi: + 31 26 352 1278

Mund të kërkohet që rezultati i testit të dërgohet drejt te universiteti në të cilin kërkohet për pranim.

- ✚ **Financimi.** Studentët të cilët dëshirojnë të vijnë si student vetë-financues, duhet të dokumentojnë se mund të financojnë studimin për një vit, ku shuma është së paku 80.000 krona (rreth 9.500 euro). Kur të pranohet kërkuesi në studim, universiteti do të përkujdeset për gjetjen e një banese. Disa universitete ofrojnë edhe bursa për student (shih më poshtë).

I.2. Procesi i përgjithshëm i aplikimit

Disa universitetet kërkojnë që të plotësohet formulari për aplikim të hershëm (preapplication form). Nëse përmbushen kriteriet për pranim, universiteti do të ia dërgoj kërkuesit formularin kryesor për aplikim me post. Kjo mund të shkarkohet edhe në internet në faqet e universiteteve.

Duhet pasur parasysh që pas datës së fundit të aplikimeve mbyllet faqja ku mund të shkarkohet formulari, por kjo hapet përsëri kur shpallet konkursi.

Formulari kryesor i aplikimit i dërgohet direkt universitetit. Së bashku me formularin duhet bashkëngjitur:

- ✚ Kopje të aprovuara nga dokumentet publike akademike (notat e shkollës së mesme, diploma nga shkollimi më i lartë, etj...) në gjuhën origjinale dhe në përkthim (anglisht) të aprovuara. Dokumenti gjatë kërkesës kërkohet që të ketë një shpjegim zyrtar të sistemit të notave dhe gradave/titujve akademike
- ✚ Kopje të aprovuara dhe vulosura nga notat e gjuhës angleze, të shkollës fillore dhe të mesme

- ✚ Një letër në të cilën duhet shkruar për arsyet e aplikimit për universitetin, për interesat, kurset që janë ndjekur në vendbanim, qëllimet/objektivet shkollore etj. Letra duhet të shkruhet në gjuhën angleze ose norvegjeze.
- ✚ Kopje të noterizuara të pashaportës. Nëse kërkuesi nuk ka pashaportë në kohën e aplikimit, atëherë duhen bashkangjitur kopje të noterizuara të formave të tjera zyrtare të identifikimit.
- ✚ Kopje zyrtare nga banka e cila dokumenton për posedimin e së paku 80.000 krona norvegjeze (afërsisht 9500 euro), apo kopje zyrtare nga dokumentacione të bursave.

1.3. Leja e qëndrimit

Pas pranimit në universitet, duhet të kërkohet një leje qëndrimi e përkohëshme për të qëndruar në shtetin norvegjez. Kjo leje është një vjecare, dhe nëse studimi zgjatë më shumë, duhet të aplikohet për rinovimin e kësaj lejeje, përpara datës së skadimit. Më shumë për këtë mund të lexohet në gjuhën shqipe, në faqen http://www.udi.no/upload/Faktaark/Albansk/Studenter_albansk.pdf

Formulari i aplikimit për lejen e qëndrimit gjatë studimit mund të merret në ambasadën norvegjeze apo te UNMIK-u. Duhet paguar për paraqitjen e kërkesës, shuma e së cilës ndryshon nga vendi në vend, dhe kërkesa duhet të paraqitet në kohë të mirë para fillimit të semestrit, sepse shqyrtimi i kërkesës mund të zgjas rreth 3 muaj.

2. KUSHTET NË UNIVERSITETET E NDRYSHME

2.1. UNIVERSITETI I OSLOS

<http://www.uio.no/english/>

2.1.1. Studentët vetë-financues

2.1.1.1 Grada Bachelor (zgjatë 3 vite)

Studentët të cilët kërkojnë për pranim në një studim për gradën e Bachelor, duhet së pari t'i përmbushin kushtet themelore (shih 1.1.)

Të gjitha programet e gradës Bachelor në Universitetin e Oslos janë në gjuhën Norvegjeze. **Secili student i pranuar në ndonjë studim për gradën e Bachelor, së pari duhet të marrë pjesë në një kurs për të mësuar gjuhën norvegjeze i cili zgjatë 1 vit**, dhe ti kaloj provimet e kursit me sukses. Pastaj studenti fillon menjëherë në studimet.

Studentët të cilët e njohin gjuhën norvegjeze nuk kanë nevojë të regjistrohen në kurse të tilla, por duhet ta dokumentojnë njohurinë e gjuhës përmes një testi i cili quhet Bergenstest. Ambasada norvegjeze zakonisht informon se ku dhe kur mund të merret testi.

Mund gjithashtu të kontaktohet Departamenti i Marrëdhënieve Akademike dhe Shkencore/Department of Academic Affairs and Research në adresën e internetit international-helpdesk@admin.uio.no për më shumë informata lidhur me testet e gjuhës norvegjeze të cilat Universiteti i Oslos i pranon.

Në këtë faqe mund të lexohet për drejtimet të cilat mund të zgjedhen për gradën Bachelor në këtë universitet:

<http://www.alb-ung.no>

<http://www.uio.no/english/academics/admission/rds/bachelors/>

Afati për të kërkuar për para-regjistrim është 1. janar. Formulari gjendet këtu:

http://www.uio.no/english/academics/admission/pre_application.pdf

Nëse përmbushen kushtet, universiteti pastaj do të dërgon formularin kryesor përmes postës. **Afati për të kthyer formularin kryesor është 1. shkurt.**

2.1.1.2. Grada Master (zgjatë 2 vite)

Studentët mund të zgjedhin nga disa programe të gradës Master të cilat jepen në gjuhën angleze. Një pasqyrë e tyre mund të gjendet në faqen

<http://www.uio.no/english/academics/masters.html>

Për t'u pranuar duhen përmbushur kushtet themelore, dhe duhet të jetë përfunduar grada Bachelor apo një diplomë e barazvlefshme në studimin përkatës.

Afati për të kërkuar për para-regjistrim është 1. janar. Formulari gjendet këtu:

http://www.uio.no/english/academics/admission/pre_application.pdf

Nëse përmbushen kushtet, universiteti pastaj do të dërgon formularin kryesor përmes postës. **Afati për të kthyer formularin kryesor është 1. shkurt.**

2.1.1.3. Grada Doktor (zgjatë 3 vite)

Për t'u pranuar duhen përmbushur kushtet themelore, dhe duhet mbaruar/arritur grada Master apo diplomë të baravlefshëm në studimin përkatës. Punime/shkrime të publikuara në lëmi do të konsiderohen.

Në këtë faqe jepen më shumë informata për përshkrimin e gradës, lëndë që mund të zgjidhen për të arritur këtë gradë, për kushtet etj. <http://www.uio.no/english/research/phd/>

2.1.2. Programe të bursave

2.1.2.1. Programi kuotor/The Quota Programme

<http://www.uio.no/english/academics/admission/quota/>

Ky është një program ku Ministria e Arsimit dhe Shkencës në Norvegji i mbulon shpenzimet e studentit gjatë studimeve. Pranimi është i kufizuar dhe është shumë kompetetiv.

Pritet që studentët të cilët marrin pjesë në këtë program, të kthehen në vendin ku kanë nënshtetësi, pas mbarimit të studimeve në Norvegji.

Programi gjithashtu i prioriton femrat, por edhe mashkujt kanë mundësi të aplikojnë.

Kriteriet për të kërkuar

 *Shkollim.* Programi është i rezervuar për studentët **postdiplomik/pasuniversitar** (për studentët të cilët

kërkojnë të arrijnë gradën Master apo Doktor). Kërkuessit duhet së pari t'i plotësojnë kushtet themelore (shih 1.1.).

- ✚ *Kushtet lidhur me nota.* Ky program ka shumë kërkuess, dhe vetem ata të cilët kanë nota më të larta konsiderohen (minimumi i notave është B+, apo rreth 9.5 me sistemin e notave në disa shtete të Ballkanit). *Njohuri në gjuhën angleze.* Duhet dokumentuar për njohuri në gjuhën angleze. Testet e aprovuara janë TOEFL (pikët minimum: 550/213) dhe IELTS (minimum 6.0) (shih 1.1.).
- ✚ **Grada Master:** (Zgjatë 2 vite) Bashkë me kushtet e përmendura themelore, kërkuessi duhet të dokumentoj edhe për mbarimin/arritjen e gradës Bachelor apo diplomës së barazvlefshme në studimin përkatës. Shih më shumë në faqën http://www.uio.no/english/academics/admission/quota/courses_master.html
- ✚ **Grada Doktor:** (Zgjatë 3 vite) Për t'u pranuar në lëmë për këtë gradë, duhet dokumentuar për gradën Master apo një diplomë të barazvlefshëm, në studimin përkatës. Shih më shumë në faqën http://www.uio.no/english/academics/admission/quota/courses_doctor.html

2.1.2.2. Erasmus Mundus

Ky është një program i ri dhe realizohet nga Komisioni Evropian. Programi jep bursa për student të cilët kërkojnë të marrin gradën Master në Arsimin e lartë (Higher Education). Për t'u pranuar këtu duhet plotësuar kushtet themelore, dhe duhet mbaruar së paku 3 vite studimi në nivel universitar.

Mund të lexohet më shumë për këtë dhe për kurset të cilat ofrohen nga Universiteti i Oslos në faqën

<http://www.uio.no/english/academics/admission/erasmus-mundus/> kurse faqja

http://europa.eu.int/comm/education/programmes/mundus/index_en.html tregon më shumë për procedurën e përgjithshme të aplikimit. Më së poshti në këtë faqe të internetit mund të lexohet më shumë për procesin e aplikimit.

Pyetje tjera lidhur me studime në këtë universitet mund të drejtohen në e-mail adresën international@admin.uio.no

2.2. UNIVERSITETI I BERGEN-it

<http://www.uib.no/info/english/>

2.2.1. Studentë vetëfinancues

2.2.1.1. Studentë të përkohshëm/Guest-student (zgjatë më së shumti dy semestra)

Studentët në universitetet të cilat nuk kanë marrëveshje këmbimi me këtë universitet, njihen si studentë të përkohshëm. Këta duhet t'i mbulojnë të gjitha shpenzimet vetë, the munden të kërkojnë pranim për një apo dy semestre në lëndë të cilat jepen në gjuhën angleze. Kjo faqe e internetit tregon më shumë për këtë http://prospective.uib.no/?mode=show_page&link_id=32&toplink_id=21

Edhe studentët universitar edhe ata pasuniversitar mund të kërkojnë për lëndë të vetme, dhe programi është vetëm pjesë e gradës/diplomës. Kjo do të thotë se studentit duhet të jetë i pranuar në një universitet në vendbanim para se të kërkon si studentë të përkohshëm. Për t'u pranuar si studentë të përkohshëm duhet përmbushur kushtet themelore (shih 1.1.).

2.2.1.2. Grada Bachelor

<http://www.alb-ung.no>

Kushtet për këtë universitet janë të njëjta si në universitetin e Oslos, ku më e rëndësishmja është se studimet janë vetëm në gjuhën norvegjeze (shih 2.1.1.1.). Studimet të cilat ofrohen për këtë gradë gjehen në http://prospective.uib.no/?mode=show_page&link_id=22

2.2.1.3. Grada Master

Studentët mund të zgjedhin nga disa programe të gradës Master të cilat jepen në gjuhën angleze. Një vështrim i tyre mund të gjehet në faqën http://prospective.uib.no/?mode=show_page&link_id=22

Kushtet për t'u pranuar janë të njëjta me Universitetin e Oslos (shih 2.1.1.2.).

Formularët e kërkesës mund të gjinden në faqen

http://prospective.uib.no/index.php?mode=show_page&link_id=136&toplink_id=21

2.2.1.4. Grada Doktor

Ky universitet ofron dy lloje të kësaj grade: Grada doktorale e "organizuar" PhD (philosophiae doctor), dhe ajo e "lirë" (Dr. philos. (doctor philosophiae)). Në këtë faqe gjendet më shumë informacion

<http://www.uib.no/info/english/PhD.html>

2.2.2. Programe të bursave

2.2.2.1. Programi kuotor/The Quota Programme

Kushtet për këtë program janë të ngjashme me atë të Universitetit të Oslos (shih 2.1.2.1.). Për studimet të cilat i ofron universiteti i Bergen-it përmes këtij programi mund të gjehen në faqën

http://prospective.uib.no/?mode=show_page&link_id=36&toplink_id=21

Pyetje lidhur me studime në këtë universitet mund të drejtohen në adresat e fakulteteve të ndryshme të cilat mund të gjehen në adresën :

http://prospective.uib.no/?mode=show_page&link_id=26&toplink_id=26

2.3. UNIVERSITETI I TROMSØ

<http://uit.no/daa/international/>

Universiteti i Tromsøs nuk ofron studime të plota në gjuhën angleze për gradën Bachelor, ofron vetëm lëndë të vetme:

2.3.1. Studentë vetë-financues

<http://uit.no/daa/students/3?SubjectId=1&From=0#admission>

2.3.1.1. Studentët e përkohshëm/Guest-student (zgjatë një semestër)

Universiteti i Tromsø-s nuk ofron programe ndëruniversitare/Bachelor në gjuhën angleze. Ofron vetëm lëndë të vetme për të cilat mund të kërkohet si student i përkohshëm/"Guest-student". Kushtet për t'u pranuar janë të ngjashme me ato të Universitetit të Bergen-it (shih 2.2.1.1.). Shiko edhe faqën

<http://uit.no/daa/students/3?SubjectId=1&From=0#admission>

Këtu gjendet formulari për të aplikuar:

<http://www.alb-ung.no>

<http://uit.no/daa/students/3?SubjectId=1&From=0#application>

Afati për të kërkuar është 1 qershor për semestrin e vjeshtës, kurse për semestrin e pranverës është 1. tetor.

2.3.1.2. Grada Master

Studentët mund të zgjedhin nga disa programe të gradës Master të cilat janë në gjuhën angleze. Një vështrim i tyre mund të gjehet në faqën

<http://uit.no/daa/students/5#postgraduate>

Kushtet për t'u pranuar janë të ngjashme me ato të Universitetit të Oslos (shih 2.1.1.2).

Formulari për Master mund të shkarkohet në faqën (pas afatit kjo faqe mbyllet, por hapet prap pas shpalljes së konkurimit):

<http://uit.no/daa/students/3?SubjectId=1&From=0#application>

Afati për të kërkuar është 1 mars.

2.3.2. Programe të bursave

2.3.2.1. Programi kuotor/The Quota Programme.

<http://uit.no/daa/students/3?SubjectId=1&From=0#admission>

Programi ofron studime për gradën Master dhe për gradën Doktor. Kriteriet për t'u pranuar përmes programit janë të njëjta me atë të Universitetit të Oslos. Këtu gjenden drejtimet të cilat mund të kërkohen përmes programit:

<http://uit.no/daa/students/5#postgraduate>

Afati për të kërkuar për studentë të gradës Master është 1 dhjetor, kurse për gradën Doktor është 31 janar. Këtu gjendet formulari për të kërkuar:

http://uit.no/daa/students/3?ws_system_search_str=the+quota+programme&ShowSearchFrom=0#application

Pyetje lidhur me pranim dhe me programet e ndryshme të bursave, mund të drejtohen në adresën international@adm.uit.no

2.4. UNIVERSITETI TEKNIK DHE I SHKENCAVE NATYRORE NË NORVEGJI/NORGES TEKNISK-NATURVITENSKAPELIGE UNIVERSITET (NTNU)

<http://www.ntnu.no/indexe.php>

2.4.1. Studentë vetëfinancues

2.4.1.1. Studentët e përkohshëm/Guest-student (zgjatë më së shumti dy semestra)

Kushtet për t'u pranuar si student të përkohshëm janë të ngjashme me ato të Universitetit të Bergen-it (shih 2.2.1.1). Kjo faqe e internetit tregon se çfarë lëndësh mund të kërkohen.

Preferohet që student mysafir të kërkojnë përmes formularit në internet së paku 3 muaj para fillimit të semestrit. Këtu mund të shkarkohet formulari

<http://www.alb-ung.no>

<http://www.intersek.ntnu.no:591/gjestestudenter/>

2.4.1.2. Grada Bachelor

Së pari duhet përmbushur kushtet themelore.

Të gjitha studimet për gradën Bachelor janë në gjuhën norvegjeze. Për këtë arsye duhet të dokumentohen edhe njohuri të gjuhës norvegjeze.

Studentët të cilët nuk kanë njohuri të gjuhës norvegjeze duhet së pari të kërkojnë për një kurs i cili ofrohet nga ky universitet, dhe zgjatë 10 muaj (Introductory Programme in Norwegian Language for International Students (IFUS) and Regular Students). Po ashtu, në të njëjtin formular, duhet kërkuar studimi i dëshiruar. Kur të jetë mbyllur aplikimi, formularët e këtij kursit nuk do të shfaqen në faqën e tyre të internetit deri në shtator.

Afati për të kërkuar është 1. dhjetor.

Në këtë faqe mund të gjehet më shumë për këtë kurs dhe për studimet të cilat jepen në gjuhën norvegjeze:

http://www.ntnu.no/intersek/gry/norskurs/html/ifus_1year_full_time_program.html

Studentët të cilët e njohin gjuhën norvegjeze, duhet ta dokumentojnë përmes një testi i cili quhet Bergens test. Ambasada norvegjeze zakonisht informon se ku dhe kur mund të merret testi. Pastaj rezultatet e testit dërgohen sëbashku me aplikim në Shërbimin për pranim në Universitete dhe Shkolla të larta (Samordna Opptak). Formulari për këtë duhet të kërkohej përmes kësaj faqe:

<http://www.ntnu.no/intersek/English/Students/degreeeeking.html>

2.4.1.3. Grada Master

Universiteti ofron 19 programe të gradës Master të cilat janë në gjuhën angleze.

Kushtet për t'u pranuar janë të njëjta me Universitetin e Oslos (shih 2.1.1.2.).

Një pasqyrë e programeve mund të gjehet në faqën

<http://www.ntnu.no/intersek/Utlysninger/Masterinfo2005.pdf>

2.4.1.4. Grada Doktor

Për t'u pranuar duhet përmbushur kushtet themelore, dhe duhet mbaruar/arritur grada Master apo diploma e barazvlefshme në studimin përkatës. Gjithashtu konsiderohen punime/shkrime të publikuara.

Një pasqyrë e programeve, formulari për të kërkuar dhe afate për gradat Master dhe Doktor mund të gjehet në faqën

<http://www.ntnu.no/intersek/Utlysninger/Masterinfo2005.pdf>

2.4.2. Programe të bursave

2.4.2.1. Programi kuotor/The Quota Programme

<http://www.alb-ung.no>

Programi përfshin vetëm studentë pasuniversitar (do të thotë për gradën Master dhe Doktor). Kushtet tjera për t'u pranuar në këtë program janë të ngjashme me atë të Universitetit të Oslos (shih 2.1.2.1.). Studimet që ofrohen në këtë universitet mund të gjehen në faqën <http://www.ntnu.no/intersek/Utlysninger/quota.htm>, kurse personi kontaktues mund të kontaktohet në adresën e e-mailit :

Ragnhild.Brakstad@adm.ntnu.no

Pyetje tjera lidhur me studime në këtë universitet, mund të drejtohen në e-mail adresën

international@adm.ntnu.no

2.5. UNIVERSITETI I SHKENCAVE AMBIENTALE DHE JETËSDRE NË ÆS/UNIVERSITETET FOR MILJØ- OG BIOVITENSKAP I ÆS

<http://www.umb.no/?avd=30>

Ky universitet fokusohet në bio-shkenca dhe shkenca hapësire/për mjedis.

Për tu pranuar në këtë universitet, duhet përmbushur kushtet themelore (shih 1.1.). Shiko në këtë faqe për informacion më të hollësishëm lidhur me kushtet

<http://www.umb.no/?viewID=1121>

2.5.1. Grada Bachelor

Të gjitha programet e gradës Bachelor në këtë universitet janë në gjuhën Norvegjeze. Universiteti nuk ofron kurs një- vjeçar të gjuhës norvegjeze, për këtë arsye studentët duhet të mbarojnë kurse të tilla në vendin ku ndodhen ose në Norvegji dhe të dokumentojnë rezultatet përmes Bergentesten-it në kërkesën e tyre. Ambasada norvegjeze në vend do t'iu informoj se ku dhe kur mund të merret testi.

Formulari për kërkesë vetëfinancues gjehet në faqën <http://www.uib.no/info/english/>

2.5.2. Grada Master dhe grada Doktor

2.5.2.1. Studentë vetëfinancues

Studentët vetëfinancues duhet të përmbushin kushtet themelore (shih 1.1.). Për gradën Master duhet mbaruar/arritur gradën Bachelor (3 vite) apo diploma e barazvlefshme, në studimin përkatës. Për gradën Doktor duhet mbaruar/arritur gradën Master apo diploma e barazvlefshme, në studimin përkatës. Më shumë informata mund të gjehet në faqën

<http://www.umb.no/?type=2&avd=9&viewID=5cf20638096fa06cf62f3d213629ef08>

2.5.2.2. Programme të bursave:

Ky universitet ofron disa program relevante për studentët:

2.5.2.2.1. Programi kuotor/The Quota Programme.

Kriteriet për të aplikuar janë të njëjta me atë të Universitetit të Oslos. Më shumë informata mund të gjehet në faqën e internetit:

<http://www.alb-ung.no>

<http://www.umb.no/?type=2&avd=9&viewID=2c0b5e7677e5deafb70afdf54e3a3ff7>

Pyetjet tjera për studim në këtë universitet mund të drejtohen në e-mail adresën postmottak@umb.no

3. KURSET E GJUHËS NORVEGJEZE

Mesa u përmend edhe më sipër, universitetet në Norvegji i kanë leksionet në gjuhën norvegjeze dhe si pasojë është testi i gjuhës i detyrueshëm. Shumica e universiteteve kanë kurse gjuhe për aplikantët, por ekzistojnë edhe rrugë të tjera për të mësuar gjuhën. Një nga më të përdorurat prej studentëve shqiptar është kursi një vjeçar në një **Folkehøgskole**.

3.1. FOLKEHØGSKOLE

Folkehøgskol-et janë shkolla 1-vjecare të quajtura shkolla "popullore" për studentët norvegjez që kërkojnë të përmirësojnë notat për tu futur në universitet ose studentët internacional që duan të mësojnë për gjuhën dhe kulturën norvegjeze. Faqa zyrtare në internet është: http://www.folkehogskole.no/english_mainpage.asp

3.1.1 Informacione praktike

Viti shkollor fillon zakonisht në fund të gushtit dhe zgjat deri në mes të majit kur është edhe data e dhënies së Bergentesten-it (test i gjuhës norvegjeze për tu pranuar në universitet). Zakonisht nxënësit jetojnë dhe studiojnë në të njëjtin vend. Kursi i gjuhës është intensiv(5-6) ditë në javë gjatë gjithë periudhës. Listën e shkollave të cilat pranojnë studentë të huaj mund ta gjeni në këtë adresë :

http://www.folkehogskole.no/english_schools.asp

3.1.2 Kushtet për aplikim

Folkehøgskol-et nuk kanë kushte specifike për aplikim dhe ato nuk kërkojnë dokumentim të arsimit të mëparshëm apo gjuhëve të huaja. Megjithatë për arsye komunikimi aplikanti duhet të ketë njohuri të gjuhës angleze ose norvegjeze.

3.1.3 Si të aplikosh

Çdo shkollë ka procedurë dhe mënyra të ndryshme në trajtimin e aplikimeve, por shumica e fillojnë procesin në muajin **shkurt**. Për më shumë informacion shikoni faqet e internetit të shkollave në adresën e internetit më sipër dhe aty mund të shkarkoni formularët e aplikimit ose të gjeni adresën dhe numrat e telefonave për ti kontaktuar direkt. Studentëve me kombësi shqiptare ju nevojitet vizë dhe kjo merret kur shkolla të ketë pranuar aplikimin. Formulari i aplikimit për vizë merret në ambasadën norvegjeze apo stacionin e punëve të jashtme në vendbanim.

3.1.4 Sa kushton viti shkollor

Viti shkollor kushton nga 45 000 në 85 000 krona norvegjeze (afërsisht 5 000 – 9 500 euro). Shkollat i specifikojnë cmimet në broshurat e tyre dhe këto variojnë nga njëra shkollë tek tjetra. Paga përmban taksën e shkollës, ushqimin, dhomën në konvikt dhe shpenzimet e tjera të mundshme.

4. RINIA SHQIPTARE & KOMUNITETI I STUDENTËVE SHQIPTARË

Në Oslo ekziston qe tre vite Rinia Shqiptare & Komuniteti i Studentëve Shqiptarë dhe ne jemi të gatshëm t'ju ndihmojmë me

<http://www.alb-ung.no>

çfarëdo informacioni që ju nevojitet. Mos ngurroni të vizitoni faqet tona në internet: <http://www.alb-ung.no> & <http://www.studenti.no>

Këtu do të gjeni të dhëna mbi komunitetin dhe se si mund të merrni kontakt me ne.

***JU UROJMË SUKSESE TË GJITHË STUDENTËVE!!!
RINIA SHQIPTARE & KOMUNITETI I STUDENTËVE SHQIPTARË NË NORVEGJI (RSH&KSSH)***